



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KATËRTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 30.04.2019 (e Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari, z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahimimi, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emimi, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, KDI-së mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e katërt të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, KDI-së mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Fillimisht dëshiroj të ju informoj, se nga ana e KQZ-së kemi konfirmimin e çertifikimit të tre anëtareve të Kuvendit Komunal të Vitisë, të cilët po e them pa fajin e tyre po thuaj se që një vit kanë mbetur jashtë kuvendit dhe sot i kemi këtu prezent. Po e shfrytëzoj rastin ta përshëndes edhe kryetarin e komunës, i cili ju bashkëngjit kësaj seance dhe meqenëse na i kanë bërë konfirmimin e anëtareve, unë fillimisht kisha dashtë që ta dhanë betimin ata dhe mandej të fillojmë me seancë. I ftoj tre anëtarët e Kuvendit Komunal që të ngritën në këmbë në mënyrë që ta japin betimin. Bazuar në nenin 35, pika 4 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28 /208, nenit 24, paragrafi 24.6 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011 dhe nenit 4 të rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr. 01-012/594, të datës 02.05.2014 të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të nënshkruajnë betimin solem si në vijim: unë (deklaroj solemnisht) se do ti kryej me nderë besnikëri pa anim e me ndërgjegje dhe sipas ligjit të detyrave do ti ushtroj autorizimet e mija si këshilltar i kuvendit Komunal të Vitisë në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë betohem urime dhe suksese. Para se të kalojmë në miratimin e rendit të ditës, dëshiroj të ju informoj, se Zyra Ligjore e MAPL-së na i ka konfirmuar ligjshmërinë e akteve të nxjerra nga seanca e fundit të kuvendit, me përjashtim të njërit vendimin për të cilin e kemi marr për ndarjen e parcelës për ngritjen e shtatores së heroit të popullit Safet Rexhepi. Mirëpo, unë në konsultim me ta sot kam kërkuar që mos ta sjellim për shfuqizim

këtë seancë, për faktin që do të bëjmë përpjekje, nëse kemi mundësi në aspektin ligjor të bëjmë brenda muajit të rregullojmë atë çështje për faktin se është një çështje jashtëzakonisht e ndjeshme dhe nuk dëshirojmë t'i lëndojmë familjet e dëshmorëve dhe ata të cilët u sakrifkuan për lirinë të cilën e gëzojmë ne sot. Po kalojmë në pyetje dhe propozime jashtë rendit të ditës. Ju kisha lutë kështu miqësisht që ta respektojmë montazhin të cilën e kemi për pyetje dhe propozime jashtë rendit të ditës. Hapim debatin, kush donë ta merr fjalën.

z.Njazi Isaku: Të nderuar të pranishëm, fillimisht më lejoni të i përshëndes anëtarët e ri të Kuvendit Komunal të Vitisë dhe të ju uroj punë të mbarë. Pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike apo më mirë për kryetarin. Meqenëse ka lidhje me punët kryesore ose thanë parësore të kësaj qeverisje, asfaltimin e rrugëve e që edhe ne si VV mos të keqkuptohemi jemi për asfaltimin e rrugëve, por ku dallojmë ne është, se ne kërkojmë cilësi dhe standarde që aplikohen për asfaltimin e rrugëve, e besoj që gjithë qytetarët e Komunës sonë tanimë po e shohin se në çfarë cilësie po e shtrojnë rrugët e tyre, andaj po i cekim vetëm dy rrugë në qytetin e Vitisë, si rruga “Hebib Sejdiu” e cila është asfaltuar në nëntor 2018 si dhe rruga në lagjen e re afër viva fersh në Viti, e cila rrugë është asfaltuar përgjatë vjeshtës së vitit 2018. Për ilustrim po i cekim këto dy rrugë me foto që i kemi bërë, ja si ka lulëzuar asfalti në këto rrugë. Kjo është rruga te viva fersh dhe fotoja tjetër që i kemi bërë, andaj me ardhjen e pranverës si stinë e lulëzimit, pikërisht në këto dy rrugë kanë filluar së lulëzuar, së gjelbëruar apo ma thjesht ju kanë nxjerr hajninë, se logjikisht edhe në rrethana normale kjo është absurde me ndodhë. Arsyeja është, se ky bari është mbjell qysh në prokurim kur është nënshkruar kontrata me kompaninë. Rrjedhimisht po ju duket se dikujt u a ka lagur fytyrën dhe mandej kemi kësi asfalte të gjelbëruara. Pyetje, a keni ndërmarr ndonjë masë ndaj kompanisë apo tani më kjo është kryer qysh në fillimet e nënshkrimit të kontratës?

znj.Hida Pira: Kërkoj informatë pse është ndërpre trotuari nga rruga Zuka deri te Ura e Kurteshit. E dyta, kërkoj informatë se është premtuar edhe nga ana e kryetarit të shtrohet rruga me zhavorr prej lagjes Halabaku deri në Viti, si dhe kam një kërkesë që të vendosen shenjat e këmbësoreve se janë shlye gati krejt.

z.Remzi Salihu: Kam një pyetje për drejtorin e DKRS-së dhe një sqarim për Drejtorinë e Financave. E para, kam një informatë, nuk e di sa është e saktë, por megjithatë me duhet ta adresoj a është e vërtetë se një kompani e kontraktuar për furnizim me material për Flakadanin e Karadakut për vitin 2017 ka bërë dy herë pagesë, një herë është bërë pagesë e rregullt për shërbimet që ka bërë, ai dhe herën e dytë me përmbarues, a është e vërtetë apo nuk është dhe për Drejtorinë e Financave kam bërë një kërkesë këtu që të dihet shuma e paguar ndaj Karitas Kosovës për vitin 2017, 2018, 2019 dhe kam këtu një shumë mjaft të konsiderueshme, megjithatë drejtori mund të thotë që nuk e keni kërkuar specifikimet, prandaj nuk e kemi shënuar. Unë nuk kam menduar të jetë një shumë kaq e madhe, prandaj edhe nuk e kam kërkuar, është për vitin 2017 shuma prej 75 mijë 620 euro, për vitin 2018 shuma është 94 mijë 300 euro, për vitin 2019 shuma është 32 mijë 176.28 euro dhe këtu shkruan për të gjitha vitet shërbimet të ndryshme shëndetësore, nëse ka mundësi me na dhanë sqarime.

znj. Mirlinda Sadiku: Për seancën tjetër kërkoj raport për të drejtat e njeriut në Komunën e Vitisë, sa po respektohen ato të drejta. Ka shumë ankesa, ka shumë edhe shkelje të të drejtave të njeriut, megjithatë do të dëshiroja në mënyrë zyrtare të kishim një raport. Kam pyetje për drejtorin e DKRS-së. Me sa shoh nuk është duke u punuar te palestra sportive me trendin që është duke u punuar, çfarë ka ndodhur, cila është problematika, si dhe kam pyetje për drejtorin e Financave. Me dëgjimin buxhetor në fshatin Skifeteraj pate thanë se unë vet personalisht ka mu përkujdes që kanali i Lagjes Zejnullahu do të hapet. A do të hapet këtë vit apo jo? Është viti i tretë me radhë që e kërkoj.

z.Sejdi Emini: Edhe unë sot kam dy kërkesa, të cilat mendoj se janë legjitime. Është bërë lidhja e rrugëve mes fshatit Smirë dhe Gushicë. Dje kam dal i kam shikuar, mirë që është bërë ajo lidhje, mirëpo ajo që ish e domosdoshme të hapen kanalet, sepse nëse nuk hapen kanalet në ato rrugë që janë rregulluar, unë mendoj se për një kohë të shkurtër njëmend na lulëzon edhe bari. E dyta, kini shpall si vit ambienti në komunën tonë, unë mendoj se bizneset tregtare të mëdha siç është Viva, ETC-ja janë ka na dëmtojnë në këtë drejtim i takon Drejtorisë së Inspeksionit. Mendoj që ato fletushka që po na i lanë nëpër dyer të oborreve, nëpër makina, duhet me u ndaluar urgjentisht dhe rrepsisht, boll i kanë mbytur bizneset e vogla, tash edhe ambientin po na i ndotin, mendoj se duhet me marr një masë edhe me i ndërprerë, se përndryshe kotë e pastrojmë ne qytetaret e ata dalin na i ndotin me fletushka.

z.Zekirja Zuka: Kam një kërkesë nga disa pronar të firmave ndërtimore, sidomos të atyre me lyrje dhe fasader, sepse pas përfundimit të punëve nëpër shtëpi dhe objekte të mëdha. Nuk po kanë ku ti hedhin mbeturinat e tyre, e kam fjalën për kofet, steropotin, keset etj. Ata kërkojnë që të caktohet një lokacion apo depo ku mund t'i dërgojnë këto mbetje që të mos i hudhin rrugëve. Ata pranojnë që edhe të paguajnë, kështu që kërkoj nga kuvendi dhe ekzekutivi që të punojnë në këtë drejtim dhe të ju krijojë kushte më të mira bizneseve për punë dhe të kemi një ambient ma të pastër.

z.Jakup Demiri: Kam një pyetje këtu për drejtorin e Inspeksionit z.Skender Ahmeti, në lidhje me restorant "Lindin", pasi që tash edhe pak fillojnë dasmat, ju keni marr një urdhëresë me 09.02.2018, janë bërë matjet, ndërsa me 5 nëntor e keni marrë një raport prej atij instituti inkos, se vlerat e zhurmës aty janë të tejkauara dhe pronari tash edhe është nderuar, por qa keni vepru si komunë ju dhe si drejtori e inspeksionit që ato mos të përsëriten ma edhe në këtë verë.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për gjithë të pranishmit! Në seancë isha lidhë edhe unë diçka. Kisha bë një pyetje apo kisha kërkuar një informatë me çështjen e zjarreve që ka qenë një numër i madh i zjarreve a ka ndonjë informatë prej kujt janë shkaktuar këto zjarre dhe çfarë dëme janë bërë me këto zjarre, se ka qenë një shqetësim për çdo qytetar të këtuhit. Një pyetje tjetër e kisha pas që a ka kompani të kontraktume që e banë transportin e kafshëve të ngordhura, që na e dimë që pjesa në Bagdat është ku gropohen kafshët e ngordhura, kur dimë se kemi shqetësime nga fermerët për këto dukuri dhe kemi rastin para një muaji, kur komuna ja jep ekskavatorin dhe e groposë te rruga e Buzovikut të fermerit Gazmend Shabiu të Kabashit dhe na e dimë që nuk lejohet, sepse është i përcaktuar vendi në Bagdat dhe ma herët ka ndodhë në rrugën e Letnicës në skaj të lumit kanë shkuar me bager të komunës e kanë bërë gropën dhe e kanë varros. Tjetra, ose tregu i kafshëve nuk bartet në vendin që e kemi që e kemi destinuar para dy viteve në këtë kuvend komunal dhe e dimë se është investuar aty për dy vite radhazi. Pse ende mbahet tregu i kafshëve te rruga kryesore magjistrale. Mendoj se është vonuar kjo çështje .

znj.Liridona Bislimi: Kryesues, me mirëkuptimin edhe tuaj ka me ngritë një çështje të cilën e kam përsëritur vazhdimisht. Bëhet fjalë për rrugën në Drobesh, dhe kam në plan ti bëjë disa komentime të çështjeve që i kanë ngritur vazhdimisht dhe besoj se do ta kaloj minutazhen, por pasi që është hera e parë që po e bëjë këtë shpresoj në mirëkuptimin tuaj. Pikë së pari është bërë një kërkesë nga disa banorë të fshatit Tërpezë, për shfrytëzimin e parcelës me mundësi shfrytëzimi për vendosjen e një pllako përkujtimore për vëllezërit Hajrullah e Saqip Terpeza. Kjo kërkesë është bërë në tetorin i kaluar, ju është ofruar nënkryetarit Hasan Aliu, pra është ky dokument i cili është thanë, se në dhjetor do të jetë punë e mbaruar, por ende familjarët nuk kanë marr përgjigje. Si qëndron puna, jemi afër datës 3 maj, ku në këtë datë shënohet dita e lirisë së mediave, por mjerisht në Komunën e Vitisë mediat në Komunën e Vitisë nuk kanë fare arsye që ta festojnë këtë ditë. Fatkeqësisht kryetari Sokol Haliti, duke pasur frikë

se mos zbulojnë mediat ndonjë skandal të tij, po i josh duke i paguar ato dhe jo vetëm mediat lokale, por çka është ma interesante edhe ato nacionale. Mbi 10 medime paguhen me para të qytetarëve nga Sokol Haliti, i cili nuk bënë asgjë tjetër, se vetëm marketing vetvetes duke keqpërdorur kështu taksen e qytetarëve të Vitisë. Unë mendoj se me këtë lloj propagande që po e banë kryetari Sokol Haliti, do ta fitoj edhe një mandat, sepse media është ajo e cila pasqyrohet. Pasi është dita e Lirisë se Mediave, kërkoj nga kryetari Sokol Haliti të i lë mediat ta kryejnë punën e vetë, sepse nëse cenohet media atëherë cenohet edhe demokracia, dhe sinjerisht nuk besoj se kaq shumë medime mi vu në funksion. Nga kërkesa që kam bërë në qasje në dokumentet publike, mbi 10 medime janë këtu që paguhen nga Komuna e Vitisë. Shuma totale për vitin 2018 është 11774 euro. Tri portale janë nga Komuna e Vitisë, tri portale janë nga rajoni i Gjilanit, tri janë nga rajoni i Prishtinës, ndërsa një portal nuk e kam kuptuar se nga cili rajon është. Zëri shpk paguhet 2280 euro, këto pare janë të taksapagueseve, të qytetarëve, pse është nevoja me pagu nga Prishtina me taksa tonat. Kryetar, pasi që ka filluar trotuari të shtrohet në Fshatin Drobesh, pse nuk ka fillur të rregullohet edhe ndriçimi dhe kur kam qenë në takim, e zëvendësministri më ka thanë, se asnjëherë nuk është bërë kërkesë nga Komuna e Vitisë. Ai është zëvendësministër dhe nuk mund ti dijë gjitha problemet e rrugëve magjistrale pa u bërë kërkesa nga Komuna e Vitisë për të ju bërë lutje, për këtë rrugë, për këtë rrugë kemi nevojë, ai natyrisht se nuk mundet me ardh në fshatin Drobesh me shiku a mungojnë vijat, a mungojnë barrierat a kush mungon. Pse nuk është bërë asnjëherë, kërkesë është në Plus TV në vitin 2017, kur është bërë një raport në fshatin Drobesh, kërkesat e banorëve, kanë qenë vazhdimisht të punohet rreth kësaj rruge, pastaj pas reportazhit është aty edhe nënkryetari Hasan Aliu, ku thotë që do të ju nënshtrohemi organeve kompetente, pastaj tash jemi në vitin 2019 pse s'keni dërgu një kërkesë ka ardhur puna deri këtu me ndodhë një fatalitet. Fataliteti i fundit ka ndodhur në ora 21:00 në mbrëmje, ndriçim nuk ka pas plani mobilitetit që është votuar këtu në kuvend, ai plan nuk është votuar rastësisht, normalisht që është lëshur edhe buxhet ku kanë mbetur paret që janë për atë plan të mobilitetit. Të kishte qenë ai ishull nga ekspertet e komunikacionit 99,9 përqind thuhet se nuk do të kishte ndodhë. Unë ju bëj kërkesë që njëkohësisht me tretuar le të bëhet edhe ndriçimi mos të ndodh si në Germovë me domtuar trotuarin, edhe dihet se fshati Drobesh është paralagje e Vitisë dhe normalisht se banoret ecin ma shumë në këmbë. Keni shkuar e keni bërë ndriçimin në fshatrat tjera e keni lanë këtë pa ndreqim.

z.Taulant Haxhiu: Unë kam propozuar në seancën e kaluar, që ditën e diele të jetë ditë pushimi, kam biseduar edhe me kryetarin edhe ai ka qenë i pajtimit që dita e diele të jetë pushim edhe sektori privat, të gjithë kanë qenë të pajtimit që ky ligj të miratohet. Kryetar, a ke marr ndonjë hap që ky propozim i imi të vjen në kuvend, dhe e dyta ju e dini që për punën e urës të shkollat e mesme kam debatuar dy tri herë dhe kam kërkuar informatë, një informatë që ma keni sjell 219 mijë euro që ka kushtuar ura, por unë desha të di të jeni pak ma transparent, se raporti i KDI-së e ka qit Vitinë në vendin e 22 për mostransparencë. Kush i ka udhëheqë procedurat e prokurimit të urës dhe kush e ka udhëheq kontratën menagjuese gjatë gjithë projektit të realizimit të projektit. Këtë e dua si informatë, kush kanë qenë këta persona se KDI ja ju ka qit e 22, tash se unë ju kisha qitë e 32 dyta.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Sa i përket pyetjes së parë, desha me të tregua, se drejtori i Inspeksionit është duke punuar rreth draftit dhe do të na vjen në seancë.

z.Vehbi Rama: Unë kam kërkuar që 6 vite, fatkeqësisht nuk është realizuar kanalizimi në rrugën “Rexhep Bislimi”. Aty të gjithë e dini, e dinë edhe kryetari, se aty kundërmon erë. Ju falënderoj publikisht gazetarëve të kohës ditore, që ma shpesh e kanë vizituar ata se sa pushteti komunal. Në dy zebat është bërë punë e mirë, veç se fatkeqësisht ato shumë shpejt po fshihen. Unë kisha propozuar që të vendosen samafora të zebrave ato vetëm vendosen mbi zebra. E treta kërkoj, pse në fshatin Zhiti ambulanta nuk funksionalizohet, është e gatshme, unë nuk

e di pse ndërtohen në fshatra tjera kur në Zhiti është e gatshme edhe nuk përdoret, aty marrin pjesë tri fshatra, Zhiti, Ballancë, Kravaricë. Tjetra, rruga ish baza e KFOR-it, aty u ndërtoa, aty është duke punuar si mbrapsht. Tjetra çka është shqetësuese, që nuk është përmend në këtë kuvend. Unë po mendoj se është shqetësuese edhe ikja e rinisë. Unë e kam një mendim personal, mos të punësojmë njerëz me baza partiake, farefisnore, klanore, po të punësojmë njerëz ata që e meritojnë. Po e marrë një shembull, më ka porosit një prind i ka 5 me fakultet. Ka aplikuar, nuk është punësuar, pardje u detyruar me shkua në Gjermani. Ka një thënie, tri arterie kryesore të njeriut janë, na shpesh kena humb pasurinë, por kemi pas shpresë. E dyta, e kena humb shëndetin po kena shpresuar me ilaçe e kena rregulluar. E treta, shpresa u humb vetëbesimi, kjo është ma e keqja për neve, përpos shqetësuese është vajtuese.

Kryesuesi i Kuvendit z. Naim Pira: Atëherë kryetar u shtrua një numër i pyetjeve, ta kisha kaluar fjalën.

Kryetari i Komunës z. Sokol Haliti: Na jemi transparent dhe përgjigjet kanë me ekzistuar. Ty të përgëzoj për tolerancën edhe pse po shkelet rregullorja vazhdimisht, për shkak se po kthehet në debat, te shërbimet publike një pyetje është bërë nga këshilltari me fillim rreth asfaltimit të rrugëve, dëmtimit të rrugëve, a janë marrë masa ndaj kompanisë, unë sot i kam lutë zyrat e mija, jemi tu mundu me shtu një profesionalist në punë. Sa e kemi arritur është çështje që vlerësohet dhe vlerësimet që janë bërë se dikush tha vendin e 32 me mujt ju kisha qitë. Ndoshta nuk na kishe lan hiq me ardh këtu, ajo është në rregull se është politikë, nëse duhet unë i thamë një zyrtari timit me sjell renditjen e krejt përfomncave për këtë vit edhe për dy vite të fundit, jam rendit ndër ma të mirët, por unë jam treguar modest, por po ju them, se tash e tutje nuk do të tregohem modest më në renditjen e MAPL-së. Kryesuesi është dashtë me qitë në kuvend këtë renditjen e MAPL-së për Komunën e Vitisë dhe unë po ju them se është e para edhe në krejt përfomncat edhe të auditorit, renditjen e OSBE-së, KDI-së dhe të GAP-it të USAID-it INDEKS Kosovës dhe renditjen e raportit të progresit, unë do ti numëroj shtatë përfomncat kryesore, ato janë: përfomnaca e auditorit gjeneral, përfomnaca dhe llogaridhënia, harxhimi i buxhetit, projekcioni, ana ligjore, ambienti i biznesit edhe për barazi gjinore kemi marr prej OSBE-së të paret në Kosovë. Te vërejtjet që i dha këshilltari, përveç me një përjashtim për mua dhe lidshipin, sinqerisht nuk vlen ajo fjali. Në Viti është ka punohet shumë dhe tash kur punohet shumë ka edhe dobësi. Nuk është e vërtetë ajo fjali që thae për shkak se ka ka 5 orë merrem me detale me këto punë. E kam ngrit edhe çështjet që ju i keni potencia. Është e vërtet se marrim masa, është e vërtet se kam kërkuar analiza të laboratorit, na jemi tu punu, kemi me tentuar me marr edhe ingjiniera të ri të cilët kanë mei nejt te vendit i punimit për shkak se jemi duke punuar shumë edhe nevojitet një seriozitet. Ju thash, po ju them edhe një herë, nuk ka shancë rruga që është dëmtuar edhe mu pagua. Mua më gëzon fakti se kemi qenë në SHBA, e kemi pas një rezultat të mirë, e kanë rikonfirmuar partneritetin Komuna e Meison, kemi pas edhe do vizita të tjera, po të kthehem te tema. Më treguan se u shtrua mirë rruga Gushicë – Smirë, unë fola edhe me këshilltarët, edhe me kryetarët e fshatrave, biseduam, do të bisedojmë bashkërisht që dalim dhe i shikojmë këto që i ngriti këshilltari, do të insistojmë se secila punë mu ba mirë dhe në afat, edhe tek e fundit ata që nuk i kryen kualitet duhet me marr masa ndaj tyre. Trotuaret pse janë ndërpre, doktoresh, kanë qenë projekt dyvjeçar, kemi pas pak pengesa individuale, ka me vazhdu shumë shpejtë edhe rrugës që e ngritën dy këshilltar, ajo do të kryhet, është shumë me rendësi edhe te sinjalistikat e kam ngrit këtë debat na atë duhet me bë të plasifikuar, ani se është ma e shtrenjtë. Këtë vit do të fillojmë me sinjalistikë të plastifikuar edhe në Drobesh ka sinjalistika te Eli Center na e patëm me fatalitet, ka qenë javë e kobshme ajo javë. Për shkak të transparencës te media, është fjala na duhet mi shpall patjetër afatet për subvencione edhe për grande që jepen nga organizata, patjetër do të jemi të detyruar. Na jemi të detyruar së paku ne tre mediume konkursin, na jemi të obliguar me bashkëpunuar me media ke pas qasje në dokumentet zyrtare për këto tema dhe do të kesh. Edhe diçka, sa kërkesa keni bërë ju dy këshilltarë një punëtor vetëm për juve

duhet me pas, edhe ato të gjitha i kam nënshkruar. Kam pas dëshirë edhe tjetra e keni derën qelë 24h, edhe mua me lejon ligji me ardh me pa a po e mban p.sh.: drejtori edhe orën e mësimit, palestra a po funksionon, a po mbahet edukata fizike, a po mungon në orë, me jep plotë të drejt ligji, sepse ne jemi krejt me e korrighu njeri tjetrin. U përmend rruga Gushicë-Smirë, do të shikojmë gjatë javës në afatet sa më parë mu kry punët përcjellëse dhe do të dalim bashkërisht me e vizitu dhe me i pa punimet. Kërkesë për hedhjen dhe mbetjen, që u bë me të drejt, sepse për mbetjet inerte ne tash e kemi fitu një grand për fat të mirë dhe me plan zhvillimor komunal e kemi vendndodhjen e mbeturinave, i kemi tri lokacione për hedhjen e mbeturinave. Kemi pas ngordhje të dhive dhe të kafshëve, kjo është sfidë, palestra sportive është projekt trevjeçar, është në vazhdimësi, është projekt që Ministria po naj ngadalëson me fonde. Kanali në Lagjen Zejnullahu, u përmend disa herë, një të cilën e kemi fillu aty kemi fillua me qel at kanalizim, do të shohim, është detyrim i joni dhe e kemi orientim gjatë këtij mandati kemi fillu me të madhe me e hap kanalet dhe ajo është në planifikim. U cek që e Dielia të jet pushim. Jemi tu punu me bë rregullore, duhet të harmonizohemi të gjithë, u ceken trotuaret në Drobesh dhe Sadovinë, ka filluar shumë më herët se sa që ka ndodh aksidenti. Edhe këto veprimet e tjera që janë bë projeksioni, ju e dini që është në një vit me herët. Magjistralja nuk është kompetencë e komunës, është kompetencë e ministrisë, adresimi, përgjegjësia e të shamet po shkojnë tek unë si kryetar, ama unë nuk i kame fajet. Unë ju kam drejtu ministrisë kërkesat me shkrim që ju kam adresu kërkesa të shumta. Unë shumë takime kam mbajt me ministrin e Infrastrukturës. Te kanalizimi “Rexhep Bislimi”, është e vërtet që e ke ngrit këshilltar, e kemi pas provu e kemi pas bë në pjesën tjetër mas stacionit të autobusëve një vij, është e vërtet që edhe kjo është planifiku, tani ka qenë më specifike implementimi i kësaj. E një nënkallim në Drobesh mundem me e ndreq, ne rrezikun e kemi prapë, mirëpo unë mendoj që trotuari, sinjalizimi dhe policia e trafikun e poshtojnë situatën. Ambullanta në Zhiti, jemi tu punu edhe pak këtu dhe do të funksionalizohet.

Drejtori z.Milot Lala: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Pyetje ishte pagesa rreth faturës së “Flakadaku të Karadakut” 2017. Me keqardhje e thamë, që kjo nuk është e vërtet që e ceku këshilltari dhe nuk qëndron. Mundeni me bë kërkesë ne qasje ne dokumente zyrtare dhe vërtetohet kjo, dhe një pyetje tjetër ishte rreth punimeve të palestrës sportive projekti rreth palestrës sportive është projekt trevjeçar. E ceku kryetari, se shumica e punëve problemi kryesor ka qenë rreth pagesave të ministrisë, përndryshe i kemi raportet e mira me kompaninë, është kompani serioze, punët po shkojnë mirë në bazë planit dinamik. Këtë vit pritet që të përfundohen punimet e vrazhda, kurse ne vitin 2020 do të finalizohet komplet projekti.

Drejtori z.Skender Ahmeti: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Pyetje ishte rreth sinjalizimit të vendkalimeve në Pozharan. Ne do të vazhdojmë për shkak se e kemi detyru kompaninë kontraktuese që të furnizohet me ngjyrë të plastifikume. I ka marr dikun mbi tre ton të kuqe, të verdh dhe të bardhë, që të jet edhe cilësia më e mirë edhe për shkak se këtë cilësi e ka kërkuar vazhdimisht kryetari dhe ne e kemi detyru kompaninë, këto ditë do të kryhet sinjalizimi. Pyetje tjetër ishte nga z.Jakup Demiri, i cili e ngrit zakonisht këtë shqetësim për restaurant Lindin që 5-6 vite që e udhëheqim Drejtorinë e Inspeksionit, jam marr me këtë çështje dhe i kam shtjerr të gjitha procedurat juridike dhe ligjore që janë në Kosovë dhe ju kam përgjigj në të gjitha rastet dhe ka bë ankesa në të gjitha institucionet e shtetit edhe tek Umbuspersoni dhe unë po ju thamë sinqerisht edhe para mediave dhe para juve, që të gjitha mundësitë i kemi shfrytëzua, kemi bë edhe matjen e zhurmës që e përmendet ju edhe pse ka qenë kompania e paautorizuar, po megjithatë e kemi shfrytëzua si mundësi sipas matjes se tyre e ka tejkalu parametrat që lejohet tek zhurma. D.m.th pajisjet të cilat e emitojmë zhurmën e jo zhurme që e shkaktojnë qytetarët si armë, mjetet piroteknike, prandaj ne atë tejkallim të matjes së zhurmës nga pajisjet e zhurmës kemi bë dhe e kemi dërgua lëndën ne gjykatë. Jam në gjendje të gjithë qytetarëve të ju shërbej deri në pafundësi, nga askush nuk

frikohem dhe asnjë diktat nga as kush nuk e pranoje. Këtu po flas në cilësinë e Drejtorit të Inspeksionit dhe çdo institucion tjetër që shkon, çoftë shkolla çoftë ambullanta për shërbime të mija, jam në cilësinë e qytetarit, prandaj asnjë qytetar nuk mundet me ma diktat zgjidhjen e problemit, zgjidhjen e problemit e bëj ballëhapur para të gjithë qytetarëve, prandaj nuk pranoj diktate çoftë edhe nga niveli qendror. Nëse është pyetje edhe ministria. Këto ditë jam ballafaquar me rastin e pulave në Budrikë, ju nuk e dini, një biznesmen i Prishtinës ka prurë pula në mesin e familjeve, ka pas ankesa zyrtare nga fqinjët, kanë thirrë Ministria e Ambientit, ka thirrë Ministria e Bujqësisë, kanë thirrë Ministrinë tjera përkatës, sekretaret, çka jeni që në kam Viti nuk po e lejon 200 - 300 pula i ka shti me një fermë, asnjë pulë pa leje nuk guxon mu vendos në Viti. Janë bërë hapat që kanë mu heq për shkak se ligji me mundëson edhe e kame kry. Çështja e varrezave të lopëve të ngordhura, është shumë një çështje sfiduese për institucionin për shkak se edhe para dy vite që jemi ballafaquar me sëmundjen e lopëve, sëmundje gungore, pastaj kemi sëmundje e brucelozës. Nëse na dalin raste pozitive, duhet me asgjësi ndoshta edhe tufa të deleve apo të lopëve që e kemi problem, se në zonën që e kemi vendvorrezen, atje pas privatizimit ata kufij, që do ta bëjmë një dislokim, është tu diskutu edhe çështja e planit zhvillimor komunal, që duhet të zgjidhët kjo çështje, po rastet kur i kemi ngordhjet të herëpashershme në ndonjë fermë, në komuna e kemi një bager të cilin e angazhojmë dhe kanjeher duhet me të zgjedhje me të mirë të mundshme. Çështja e pushimi të Dieleve, e kemi ngrit para 5-6 muajve dhe për shkak të procedurave që janë, edhe në muajin Maj është problem me dal në kuvend, po në Qershor besoj që do ta kryejmë. Po çështja me sfiduese është të implementimi, sepse ne duhet me lan një dispozitë aty, që me e sanksionu që ju do ta caktoni këtë. Çështja e zebrave me ndriçim që e ceku Vehbia, ne e kemi mendu edhe çështjen e disa vendeve, ku i kemi vendos, po gjatë pastrimit të bores, mirëmbajtjes së rrugëve dimërore, i kemi prish ato dhe u dashtë me i heq ato zebra.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Me disa pyetje që patën të bëjnë me Drejtorinë e Financave u përgjigj kryetari, po pyetjen e Remzi Salihut për shpenzimet për KARITAS Kosova që janë bërë dhe përmes kërkesës me shkrim që e keni bërë ju në drejtorinë tonë, ne ju kemi përgjigj, shënimet i keni marr sipas viteve 2016-2017-2018 janë kryekëput shënimet e sakta që janë nxjerr nga pasqyrat financiare që kanë të bëjnë me shpenzimet e KARITAS Kosova, ashtu ka qenë edhe kërkesa nga ju. Pyetja tjetër nga znj.Mirlinda Sadiku. Po premtim nuk kam dhënë vetëm për kërkesën, po për të gjitha pyetjet ne debate me qytetar, asnjëherë nuk jap premtim, se e di çka do me thanë premtimi. Unë jam një hallk në procesin e vendimmarrjes dhe të planifikimit e të ekzekutimit, gjithmonë nuk gaboju në këtë drejtim, se është keq po kam premtu që do të interesohem me e shti në buxhetim, në planifikim këtë kanal, se është një problem që po përsëritet që disa vite dhe për at kam premtu që do të angazhohem, ama nuk kam thanë që do ta kry. Po besoj që shpejt edhe ky problem do të kryhet.

z.Remzi Salihu: Faleminderit për sqarim drejtorit të Financave dhe të Kulturës. Me drejtorin e Financave u morrem vesh shkur, ndërsa me drejtorin e Kulturës edhe ai shume shkurt ma tha, që sa e vërtet dhe kaq, po megjithatë drejtor, porosia është bërë jashtë linjës buxhetore, prandaj dhe kompania është detyruar që me përmbarues ti kërkoj këto mjete. Kjo është më se e vërtet 200%, prandaj edhe do të interesohem për këtë dokument.

z.Nijazi Isaku: Meqenëse kryetari heci, na majti fjalim nja një orë dhe përgjigje nuk na dha, ku patëm pyetje, a janë marr naj masë ndaj kompanive që kanë bërë punë jo të mira, a ka ndonjë dënim apo shkëputje për ato kompani, ndërsa për një pyetje që ke një indice, ku kryetari në fund në formë indirekte e gjuajti, mendoj më shumë njerëzve tonë që punojnë në arsim, i paralajmëroj, është fjala me pesh e kryetarit para kuvendit me tha që në një far forme vijmë ju vizitojmë që nuk e keni hap sallën sportive, këtu ke aludimi ndaj përfaqësuesve tanë, po masi nuk qenka këtu kryetari, nuk di a e dëgjon këtë.

znj.Mirlinda Sadiku: E di që me rregulla, kur një person nuk është prezent nuk banë me fol, po megjithatë na nxiti kryetari, mirë do të ishte këtu një far forme në thonjëza na kërcënoj neve të arsimit, po për mu nuk prish punë desh le të vjen në orën e parë desh në të shtatën, unë jam ne kryerje të detyrës. Po kryetari është mirë me ditë se çfarë ka ndodhë me sallën e edukimit fizik, që e kanë leju qasje shumë e shumë personave, ku aty ka prezencë edhe dugjave të cigareve edhe berllog edhe nuk mundesh me mbajt ore prej plunit, kjo është shqetësuese. Sa i përket kanali Zejnullahu, para tri vite e kam prezentu një peticion, nuk ka qenë kjo legjislaturë, ai tha jam bashkëpunues në interes të qytetarëve. Me pas qenë në interes të qytetarëve qat kanal e kishe hap e jo atje poshtë në fund, ku nuk jetojnë njerëzit, e këtu rrezikohen jeta e fëmijëve, ata fshati janë anku për jetën e fëmijëve të tyre, d.m.th nuk është që është bash pa rendësi kjo, për atë arsye kam cek dhe potencia drejtor, pikërisht shumë keq që nuk të kame ingjizu, se tash duhet me fillu edhe me ingjizu se me ki thanë do të premtoj që do ta shti në buxhet, do ta buxhetoj. Unë po të premtoj dhe mbaj për fjale, kështu me ki thanë, po megjithatë njerëzit po harroj, është njerëzore me harru po jo edhe mos me pranu, sepse ju jeni dëshmitar që edhe në legjislaturën e kalume e kam kërku edhe jam mundu me e sensibilizuar edhe më shumë rëndësinë e këtij kanali, sepse njerëzve ju ka hy edhe në shtëpi, janë detyru me i mbyll banjot. Sa i përket për gropën që e tha, kryetari te Elvi Demiri nuk e paska informatën e bollshme, aty sipas Zyrës se Prokurimit, z.Fadil Abazi ma ka konfirmu, që ju kanë dal probleme tjera, nuk po gjejnë pikën e ramjes, e aty ku e kane gjet qytetarët, është pronë private, kane dal procedurat tjera.

z.Taulant Haxhiu: Kryetari nuk po mundet me i përballur replikave të asamblistëve. KDI-ja e ka radhitur të 22-tën, po nuk e kam thanë more unë a është dikun që e kam thanë unë, unë e kam pa që nuk ka transparent, ku radhitet e 22-ta Vitia, nuk jam tu bë politik, Vitia nuk ka transparencë për sa ka transparencë unë e kisha qit Vitin të fundit edhe nuk pajtohem me 22-tën unë. Propozimi për ditën e Diell të jete pushim, ishalla nuk e vonon shumë drejtor, e di që ti mundohesh me kry punën ashtu, po kryetari tash po e pengon që e ka propozu Taulant Haxhiu. Mundet me ndodhë që edhe e vonon, dëshira e imja dhe e gjithë qytetarëve që në muajin Qershor vetëm të jete ky vendim. Kryetari e tha që ka ndodhë një rast para gjashtë viteve, kur e ka marr pushtetit edhe në mënyrë politike e përdori gjysmë ambulancë, ai çdo sen e përdor për poena politik të vet, po le të më kallxon z.Sokol Haliti, se që gjashtë vite çfarë projekti gjigand ka bë. Na e dimi që në Viti sheshi me të mirin ne Kosove e ka ndreq PDK-ja, shkollën “Januz Zejnullahu” e ka ndreq PDK-ja, shkollën “Dëshmorët e Vitisë” e ka ndreq PDK-ja. Ju e keni me të mirën propagandën edhe për pisha, për pisha renditni të paret në Kosovë.

z.Jakup Demiri: Drejtori e tha që i ka shtjerru të gjitha mundësitë, unë nuk e di këtë, po problemi është se tash edhe një muaj fillojnë darsmat aty, dhe tash ata qytetarë dojnë qetësi, se ja garanton ligji. Ti je drejtor i Inspeksionit, ke të drejtë me ja ndërpre punën nëse i tejkalon qato, po rezultatit kanë rezultu në favor të banorëve aty, që kanë pas drejt për sa vite nuk e ke kry punën. Po ta thamë nersy, unë mu pas kanë në vendin tanë isha kuq para tyre. Bëhen aty mbi 100 darsme. Thave që nuk pranoj presion, ti zbatohe ligjin për punët që i ki kry. E dimë, i ki vnu shiritat ti kanë hek me kam dhe nuk të kanë vet hiq. E ke pranua edhe në këtë foltore, ke leshu aktvendim restorant “Lindi” që obligohet që të merr masa në zvogëlimin e zhurmës në nivel të caktuar sipas ligjeve në fuqi. Në direktivat e BE-së, çka ke ndërmar ti për këtë, a i ka rregullu ai këto, unë jam tu marr me këtë punë dhe do ti shkoj deri në fund kësaj çështje, këtu me ki përball, asgjë nuk kam personale me ty, tash dalim pimë kafe, ama punën duhesh me kry.

znj.Liridona Bislimi: Singerisht është mjaft interesonte të kryetari me përgjigjet që janë jep, gjithmonë e aludon në at mënyrë që i konvenon atij, pyetjet që i bëra unë p.sh.: pyetjet që i ka paguar portalet, kryetari tha që në tri portale kemi nevojë për mu pagu, unë po i kuptoj tri portale nga Komuna e Vitisë, po pse tri portale nga Komuna e

Gjilanit dhe tri portale nga Komuna e Prishtinës, çka është nevojë që këto para të qytetarit të Komunës së Vitisë të shkojnë me një vend tjetër. Te çështja e protestës, është mëkat për një kryetar një çështje kaq djeshme që e merr dhe e kthen në një mënyrë politike protestën, nuk e ka organizu VV po as unë protestën, e ka organizu këshilli i fshatit me banorët, protestë kanë qenë ata persona, të gjithë aty që kanë pas aksident, o me fatalitet o me dëme materiale o me lëndime. Unë këtu e kame përmend që kam pas dy anëtar të familjes time, vetëm me një klikim të lehtë në google, shkruje fshati Drobesh, del aty, ja ku është diskutimi buxhetor. Nuk e kam shkruar unë këtë, është faqja e Gjilanit. U mbajtën diskutimet në fshatin Drobesh, ja ku është fotografia, ja ku janë edhe kërkesat që janë bë nga banorët e fshatit. Që gjashtë vite kërkojmë një objekt të ri shkollor, trotuari, ndriçimi, nënkalimi etj etj. Kjo i bien, që sipas kryetarit në qenkemi duke bë politik që gjashtë vite, po mirë bre, masi po e merr ky politik, le ta bënë bre për politik. Si është e mundur me u bë trotuari pa ndriçim. Unë këtë e kërkoja nga kryetari. Kane ndodh katër aksidente brenda ditës.

Drejtori z.Skender Ahmeti: Në ato rrethana nuk guxoj të lëshohem unë për shkak se unë vetëm në aspektin ligjor flas këtu. Po me vjen mirë që edhe ato bisedat interne që i pasna pas me palë po i dishit ju z.Demiri, po unë po ju tregoj shumë sinqerisht, që edhe gjykata e ka hedh poshtë, për shkak se në ligj nuk shkruhet sa dëgjues lejohet e sa nuk lejohet në standarde të BE-së, po në ligj jo, prandaj e ka hedhë poshtë gjykata, prandaj ti ballafaqov me mu sa të duash, se unë at e kame me afër se ty, njërin aty e kam bashkëvendës, të tjerë janë fqinj të Tërpezës. Mu me shqetëson shumë ai problem dhe e di që kanë shqetësime po aq lejohen dispozitat ligjore që të marr masa. Unë nuk muj me marr masa radikale qysh po thu ti, me ja mbyll menjëherë lokalit, pa u shterr procedurat nuk mundesh me ja mbyll kerkujt lokalit, se nesër të padit, po edhe nëse unë nuk jam duke vepruar për mos veprim timin, jo ju, po edhe ata, edhe të gjithë të tjerët le të bëjnë padi, kallëzim penal ndaj meje, edhe unë jam i hapur, jam i vendosur, sepse vetëm me ligj punoj, për qata unë nuk frikohem, se për tjerat nëse unë jam i korruptuar apo diçka, nuk guxoj me fol këtu, për qata jem i vendos para të gjithëve edhe para prokurorisë, e ku jam ballafaqu edhe me prokurorin me kësi telashe, se nuk e uli kokën nga askush deri sa punoj drejt.

z.Jakup Demiri: Drejtor, nuk ke nevojë mu nxeh hiq bre, punën nuk e ke kry që pesë vite, hanez tash e ki marr iniciativën me bë diçka masi kemi dal na. A keni marr diçka ndaj këtij dokumenti që e keni nxjerr, ku thuhet të bëhet izolimi i objektit me qëllim të zvogëlimit të nivelit të zhurmës a e ka bë izolimin, të ndryshoj hyrjen, portën ta vendos në anën e kundër të banorëve, a e ka bë këtë, të bej matjen e nivelit të zhurmës para sezonës së dasmave a i ka kry këto punë, se ketë dokument e ki nënshkruat ti, nëse ai i ka kry këto punë, në rregull, sepse ti e ki aktvendimin.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit të gjithëve për kontributin që dhatë. Për seancën e katër të rregull të Kuvendit Komunal të Vitisë, kemi parapa këtë:

Rend dite

- 1. Dhënia e betimit të anëtarëve të Kuvendit Komunal znj. Zejnepe Osmani, znj.Taibe Ibrahimimi. z.Ramadan Deliu.**
- 2. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e rregullt e KK-Vitisë;
b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e rregullt e KK-Viti.**
- 3. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2019**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen qytetar nderi ishe Presidentin e Republikës së Shqipërisë z.Bujar Nishani.**

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit me nr.01-410/03-71 të datës: 08.02.2018, të KKSB.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik për propozimin rregulloren mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik për propozimin rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunale Miqësorë për fëmijë.

A ka dikush rreth rendit të ditës.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Me lejoni të ju përshëndes të gjithëve, kërkojmë mirëkuptimin e juaj që sot e kam me veti edhe shkresën e ministrisë së MAPL-së, e cila e ka një fond prej 1 milion euro. Në këtë fond munde të konkurroj të gjitha komunat të cilat kane bashkëpunim ndërkomunal me një komunë dhe ne si bashkëpunim për shkak se i ka tri projekte me të cilët duhet të konkurrojmë. Komunën me të afërt e kemi Kllokotin dhe kërkohet një marrëveshje e bashkëpunimit ndërkomunal. Unë jam në gjendje edhe me jav lexu shkresën po nëse nuk e kemi një marrëveshje të tillë sun aplikojmë në këtë projekt. Neve na duhet me pas marrëveshjen e bashkëpunimi, tani a do ta marrmi apo jo projektin na mbetet me pa, shpresojmë që do të përfitojmë nga ky projekt, andaj kërkoj nga ju që të hini në rend dite nisma e kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal me Komunën e Kllokotit. Në fushën e infrastrukturës rrugore është një projekt prej restaurant “Lindit” deri në Kllokot që do të jete trotuar dhe ndriçim publik, është Pozharan-Kllokot që do të jete tretuar dhe ndriçim publik dhe tjetra Viti-Mugillë, që do të ketë vetëm tretuar jo edhe ndriçim publik.

Kryesuesi z.Naim Pira: Tu e pas parasysh që këto janë fonde të ministrisë, nuk janë fonde të buxhetit komunal të Vitisë, unë kërkojë mirëkuptimin e juaj, meqenëse përfitojnë qytetaret, e kush është që të hinë kjo pikë rend dite me ngritje dorë, 25 këshilltar janë prezent. Me 13 vota pro, 11 kundër, 1 abstenim, konstatoj se hyn edhe kjo si pikë në rend dite. Atëherë më mbetet që ta qes në votim miratimin e rendi të ditës. Kush është që të miratohet rendi i ditës. Me 13 vota pro miratohet rendi i ditës.

Pika e dytë të rendit të ditës:

3. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e rregullt e KK-Vitisë
- b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e rregullt e KK-Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat rreth procesit. A ka ndonjë vërejtje. Nga të gjithë të pranishmit u miratua procesverbali.

A jeni të pajtimit që pikën të cilin e propozoj nënkryetari të qesim në diskutim. Tani pasi që nënkryetarit i diplomon reja, e duhet me qenë në Prishtinë në ora 12, në mënyrë që duhet ta diskutojmë këtë çështje. Materialin e shpërndajti sekretaria, a jeni dakord që të diskutojmë tani, me ngritje dore nga të gjithë që ishin prezent u votua që tani të diskutohet pika:

Pika e tretë e rendit të ditës:

4. a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal me Komunën e Kllokotit, në fushën e infrastrukturës rrugore.
- b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë për bashkëpunimin nder komunal me Komunën e Kllokotit në fushën e infrastrukturës rrugore.

c) Propozim vendimin për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Kllokotit për bashkëpunimin nder komunal me Komunën e Kllokotit në fushën e infrastrukturës rrugore

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Materialin e pranuar nga sekretaria, edhe Komuna e Kllokotit e ka miratua këtë nismë, kërkojnë nga ju që të miratohet kjo pike dhe të vazhdojmë tutje.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, unë e qes në votim për miratim me një abstenim, të tjerat pro. Konstatoj që u votua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

5. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2019

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasqyrat financiare përgatiten në baza tremujore dhe dërgohen për shqyrtim në kuvendin komunal, gjegjësisht edhe në KPF. Pasqyrat financiare paraqesin raportin e ekzekutimit të buxhetit të miratuar nga Kuvendit Komunal i Vitisë. Këtë radhë kemi të bëjmë me pasqyrat që kanë të bëjnë me periudhën janar-mars 2019. Në total për këtë periudhë buxheti është shpenzuar në përqindje prej 76.53%, i shpërndarë nëpër strukturat shpenzuese duket kështu, për paga dhe mëditje 99.94%, për mallra dhe shërbime 52%, për komunal 94.68%, për subvencione 35.3%, dhe për kapitale 20.55%. Këto janë ato përqindje që kanë të bëjnë me ekzekutimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetjet e juaja jam në dispozicioni e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ata që e tha drejtori janë të pasqyruara në pasqyrat financiare. Shpenzimi i buxhetit për periudhën janar-mars 2019 është në shkallen e përgjithshme nëse i marrim edhe drejtoritë dhe të gjitha zyrat dhe për shpenzimet e projekteve kapitale dikun 76%. Më gëzon fakti që kemi një rritje të të hyrat vetanake, që ato të hyra vetanake në mënyrë direkte ti ju kthehen qytetarëve për investime në projekte kapitale. Ajo të investimet për projekte kapitale është fillimi i vitit. Tremujori i parë është koha kur të fillojnë tenderimet përmes Zyrës së Prokurimit dhe dinamika dijet kur fillon dhe kur është vllugu me i madh i punëve. Kemi në mënyrë të ligjshme të shfrytëzuar buxhetin, prandaj na mbetet që ato që i kemi votu t'i realizojmë, t'i zbatojmë dhe të jemi konform ligjit.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Jemi në diskutim të pasqyrave për periudhën janar-mars 2019. Drejtori i Financave e ka obligim ligjor me e raportu çdo tremujor, gjashtëmujor dhe njëvjeçar. Raportimi është bë rutinë dhe përsëriten gjerat, po duke ju referuar raporti këtu del që këtë vit kemi një inkasim me të madh. Sa i përket sidomos tatimin në pronë, nëse të dhënat janë të sakta, atëherë shumë mire. Te shpenzimet, azhurnimet e faturës, ose kemi shpenzime ose kemi mos procedurë të faturave me kohe. Ps.h.: te pasqyra e ekzekutimi të buxhetit për të gjitha njësit buxhetore te kodi 13130, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit këtë vit janë rrit për 1950 euro në raport me vitin 2018. Sigurisht drejtori na jep një sqarim çka është në pyetje këtu. Po ashtu te shpenzimet e rrymës, buxheti kodi 13210, kemi ulje të shpenzimeve në raport me 2018, tu e ditë se elektrifikimi është rrit shumë në Komunën e Vitisë, nëpër rrugë, nëpër fshatra. Po ashtu të shpenzimet e mbeturinave, telefonisë fikse, te shpenzimet e rrymës, kemi një rritje. P.sh.: te shpenzimi i ujit dhe të rrymës, kemi rritje bukur të madhe, dikun mbi 50%. Te shpenzimet e telefonisë mobile kemi rënie në raport me vitin 2018, dike për 4000 euro. Faqe nr. 4, furnizim me lëndë djegëse, ku i krahasojmë dy periudhat, del se këtë periudhën e vitit 2019 në krahasim me periudhën e vitit 2018 kemi shpenzime për 9679 euro më shumë se vitin 2018. Këtu me siguri kanë ardh faturat me vonesë. Drejtori na jep sqarime. Sa i përket mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve, edhe këtu e kemi një dallim. Vitin e kaluar kemi shpenzu 4211 euro, këtë vit 8224 euro edhe këtu pres një sqarim prej drejtorit të Financave. Te mirëmbajtja e autorrugëve lokale, po ashtu kemi një dallim në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Investimet kapitale

janë 119 mijë e 125 euro, ndërsa janë me të mëdhaja se vitin 2018. Unë e dëgjova parafolësin tim, kur tha, që investimet kapitale. Është e vërtetë që jemi pak mbrapa, po megjithatë kur e krahason me buxhetin e tërësishëm, jemi shumë poshtë dhe nëse tash projektet lihen mu realizu në gjashtëmujorin e dytë të 2019-së, atëherë ne po ngutemi edhe presion po ju bëjmë operatorëve ekonomik dhe shumica e investimeve kapitale nuk po realizohen me cilësinë që duhet mu realizu. Është mirë në tremujorin e parë mu përqendru në kontratat që janë me furnizim dhe shërbime, në mënyrë që mos mu vonu tu marr me investime kapitale. Te Drejtoria e Inspeksionit. Më ra në sy këtu, që mallrat dhe shërbimet që kjo drejtori i ka të ndara me buxhet, i ka shfrytëzuar shumë pak, dikun 4.36%. Për këtë periudhë na kemi vërejtje. Te Drejtoria e Inspeksionit, unë e pash me herët, drejtori u emocionua, po perime tash kur e sheh këtu, ka dash bile bile minimumi 15-20% me i shpenzuar mjetet, me qellim që me i parandalu disa gjera me kryesore. Na e dimë që qytetarët e pa ndërgjegjshëm bëjnë shkelje shpesh. Ne punët që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Inspeksionit, faqe nr. 9, vitin e kaluar e kemi pas një kod 13420, shërbime të përfaqësimit dhe avokaturës që kemi shpenzuar dikun 5800 euro ne tremujorin e parë të vitit 2018. Në këtë raportim ky kod nuk është hiq. Faqe nr.19, të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikuar dhe të realizuara për periudhën janar-mars 2019, planifikim jo i mirë po ashtu si vitet e kaluara, ku gjatë planifikimit shpesh kemi dështu me ja qellu. Edhe këtë vit shihet në baze të përqindje vjetore, realizimi në tremujorin e parë. Në shumë pozicione është shumë i ultë, nuk është qellu, është mirë këtu me qenë pak me insistua me kreativ në planifikim. Faqe nr. 20, të donacionet, sipas raportimit del, se kemi donacione në këtë periudhë dukshëm më shumë se tremujori i viti 2018, shkalla e realizimit është 19.47% përafërsisht. Nuk është keq kur e krahasojmë me 2018, po duhet me insistu me e mbajtur këtë trend dhe me rrit. Në periudhën janar-mars 2019 janë realizu të hyrat me të lartë prej 410315 euro. Tash këtu po kam qef me ditë, sa ka qenë planifikimi me i inkasuar në 2018 dhe sa në 2019. Me e ditë, që ku jemi pak a shumë me përqindje, sa e kemi traqetin. Faqe nr.23. Këtu është bënë një prezantim analitik i investimeve, i periudhës janar-mars 2019. Unë e shoh që do kompani që i kanë krye do punë, i kisha lutë ekzekutivin që të keni mbikëqyrje ma të drejt dhe me të sigurtë. Sa i përket realizimit të projekteve, se kanë ankesa për cilësinë dhe kualitetin e punëve që bëhen jo vetëm ne Viti po në tërë Kosovën, dhe ne faqe 24 prezantimi i investimeve sipas burimit të financimit për periudhën janar-mars 2019. Sa shihet këtu për momentin, këto investime janë grande qeveritare. Nuk kemi d.m.th shpenzime të të hyrave vetanake, as donacione, qëllimi i krejt kësaj është që të hyrat investimet kapitale duhet të rriten në raport me shpenzimet për mallra dhe shërbime. Nëse e krahasojmë vitin 2019 me 2018, shohim se në këtë tremujorësh, investimet kapitale kanë rënie. Në raport me 2018, kemi 20.55% investime kapitale në raport me 31.58% në vitin 2018.

Drejtori z.Ibrahim Rama: U parashtruan disa pyetje, do të mundohem të përgjigjem. Ky raport pasqyron saktë shpenzimet e buxhetit të planifikuar ne vitin 2018 për vitin 2019. Edhe me dashtë me tejkalu, ka fonde të mjaftuar se buxheti është njëvjeçar, po kësaj radhe është fjala veç për periudhën tremujore. Kështu që edhe me përqindje edhe me fond financiar të buxhetit për vitin 2019 jemi larg, që me pas mundësi me bënë naj tejkalim apo ndonjë ndryshim, duke u bazuar që edhe ligji naj mundëson me ridistinim dhe rishikim të buxhetit me e ndryshu pozicionet e buxhetit, i cili është miratu nga ju. Kështu që këtë drejtim jemi paqte, gjitha pozicionet që janë të pasqyruarat në pasqyra financiare janë të sakta, tu fillu edhe për rritjen e të hyrave vetanake për 41 mijë janë të sakta, kurse për tatimin në pronë kemi një planifikim tremujor, 90 mijë euro, ndërsa i kemi grumbullu 87 mijë e diçka euro. Pra, është një përqindje 90%. Në këtë drejtim jemi afër, disa masa për ngritjen e të hyrave nga tatimi në prone jeni informu edhe përmes mjeteve të informimit po edhe në kuvend. E kam sensibilizu këtë problematikë, përndryshe është pjese e buxhetit dikune 11 deri 12%, e buxhetit financohet nga të hyrat vetanake dhe këto drejtpërdrejt ju kthehen qytetarëve në të mira materiale përmes investimet kapitale. Gjitha shpenzimet që u ceken më shumë ose me pak, është tabela e fundit e krahasimit të shpenzimeve ne faqe 26 dhe 27, ku shihet secili kod ekonomik sa është shpenzuar këtë vit, cilët janë shpenzimet e paguara të mbetura nga viti 2018 dhe cilat janë të reja, kalkuloni, ku shihen

saktë, sepse këto shpenzime janë edhe të vitit 2018. Një diçka që duhet me sqaru, shpenzimet e buxhetit për investime kapitale, më shumë me pak, unë shumë herë e kam shpjegu këtë problematik. Sameti e dinë, sepse është ekonomist. Në çoftë se unë kame mujt me bë 100% shpenzime të investimeve kapitale, asnjëherë nuk dijet saktë kur do të nënshkruhen kontratat për projektet që dalin në tender. Kështu që, me është dash patjetër me siguru mjete financiare, se dinamiken e të hyrave për investime kapitale e caktojmë na tu kërkju nga Ministria e Financave dhe ato naj qesin baza tremujore për investime kapitale. Nëse unë nuk i kisha kerku mjetet financiare, buxhetin për investime kapitale që kontratat nënshkruhen në Prill, atëherë unë kisha mbet me i nënshkru në Qershor ato kontrata. Buxheti me kish dal zero zero, pasqyrat financiare e unë kontratat i kisha vonu nja dy muaj ditë, kështu që, në financa janë do hapa që për opinionin nuk janë të pranueshme, po në realitet janë substanciale, dhe d.m.th mirë të kuptueshme që unë mjetet i kam dhe përqindja del e vogël sa kame pagu dhe sa kame mjete në buxhet, po kontratat kur të nënshkruhet ato mjete. Unë nuk muj me i nënshkrua nëse nuk i kam mjetet në buxhetin e Komunës së Vitisë, kështu që, mos të ju shqetëson asnjëherë përqindja e ekzekutimi për investime kapitale, si shpenzim i vogël, sidomos TM1, TM2. Ajo shkon tu u rrit, d.m.th me TM3 duhet mu kanë përqindja më sublime e shpenzimit të buxhetit për investime kapitale, kurse në fund duhet mu kanë 100% siç ka ndodhe që pese vite.

Si pikë të pestë kemi të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen qytetar nderi ishe Presidentin e Republikës së Shqipërisë z.Bujar Nishani

Kryesuesi z.Naim Pira e bënë prezantimin e këtij propozim vendimi dhe hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk pate për diskutim e hodhi në votim që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës, ku me votat e përgjithshme u miratu kjo pikë.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit me nr.01-410/03-71 të datës: 08.02.2018, të KKSB

Kryesuesi z.Naim Pira: Kemi të bëjmë me ndërrimin e Komandantit të Stacionit Policor në Viti, ku ka ardh komandanti i ri, e bazuar në udhëzimin administrativ duhet edhe ai të jete anëtar i KKSB-së. Tani fjala është për ndërrimin e komandantëve të Stacionit Policor në Viti. Unë e hapi debatin, pasi që nuk patë për diskutim, e qes në votim. Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj se me votat e përgjithshme u miratu kjo pikë.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik për propozimin rregulloren mbi themelimin dhe strukturimi e Asamblesë Komunale të Fëmijëve

z.Flamur Zeqiri, udhëheqës i sektorit për të drejtat e komunitetit: Përshëndetje kryesues, ju të pranishëm! Unë prezantoj pare juve dy rregullore që e keni para vete, që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të tyre fillimisht do të doja të I jap një përkufizim në lidhje me këto dy rregullore, që pastaj të vazhdoj ti elaboroj edhe rregulloren e pare dhe të dytën, e cila ka të bejë me fëmijët. Që të dy këto rregullore ofrojnë terësinë e rregullave dhe normave të cilat shërbejnë për të siguru mbarëvajtjen e punëve në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Është vlerësu profesionalisht, që këto dy rregullore janë të konceptuar mirë, kanë organizimin e mire dhe mënyrën e veprimit përkatësish se si do të zhvillojmë punën e vet të gjithë akteret të cilët janë të përfshirë tash në këtë rregullore, që për synim ka të bej me promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave, fillimisht ne bazë të legjislacionit të Kosovës dhe pastaj mbrojtjen e tyre të drejtave

edhe nga zyrtaret dhe institucionet që kane përgjegjësi sociale dhe ligjore e autoritet për realizimin e këtyre të drejtave në praktik. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Flamuri i përfshiri të dy rregulloret gjate prezantimit të tij. Unë hapi debat për këto pika të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim të dy rregulloret që janë për diskutim publik i qes në votim Konstatoj se me votat e përgjithshme u miratu kjo pikë. Me kaq e përfundojmë këtë mbledhje, duke ju falënderuar për kontributin e dhënë.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:20 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Naim Pira
